



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 109/ Prot.
3

Tiranë, më 09 3 2016

REKOMANDIM

Nr. 03 datë 09 3 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe neneve 77-97 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999, "*Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar në ngarkim të kontrolluesit Kontrolluesit, klinika "*KEIT*", me formë ligjore të aktivitetit, person juridik,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhërit Nr. 12, datë 29.01.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u realizua kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, si më lart cituar, me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesve të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat e për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Gjatë kryerjes së veprimeve administrative procedurale, në datat 03.02.2016 e vazhdim, pranë këtij kontrolluesi, grupi i kontrollit konstaton:

- 1- Kontrolluesi, klinika "*KEIT*" sh.p.k., ushtron aktivitet në fushën e shëndetësisë estetike, ka njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave, në zbatim të nenit 21-22 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.
- 2- Kontrolluesi, klinika "*KEIT*" sh.p.k., ka një rregullore, në funksion të aktivitetit me orientim estetik të pacientëve, ku janë përfshirë disa parime bazë mbi konfidencialitetin, por jo e detajuar sipas standarteve të parashikuara në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe akteve të tij nënligjore.
- 3- Kontrolluesi, klinika "*KEIT*" sh.p.k., e ka të parashikuar në rregullore deklaratën e konfidencialitetit për punëmarrësit, por jo të bashkëngjitur kontratës së punëmarrësve,

sipas standardit të parashikuar detyrues të Vendimit nr.6, datë 05.08.2013 të Komisionerit.

- 4- Në dokumentin informues për marrjen e konsensusit (pëlqimit), kontrolluesi “detyron”, subjektin e të dhënave personale-pacientin të japë pëlqimin, duke mos aplikuar zgjedhjen alternative të tij, duke mos i lënë mundësi refuzimi, shih pikat 6 dhe 7 të këtij dokumenti.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe në kuadër të problematikave të hasura në sektorin e shëndetësisë,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, kontrolluesi detyrimisht të hartojë rregulloren sipas standardeve të shprehura në aktet e dala nga Komisioneri, dhe në përshtatshmëri me interesat e vetë kontrolluesit.
2. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi detyrimisht të hartojë “Deklaratën e Konfidencialitetit”, sipas standardit të parashikuar në Vendimin Nr.6 datë 05.08.2013 të Komisionerit.
3. Në zbatim të nenit 15 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi të riformatojë dokumentin informues për marrjen nga pacienti të konsensusit për të dhënat e tij personale, në formë opsionale, me qëllim ezaurimin e të drejtës së subjektit për të kundërshtuar, kur vetë subjekti e sheh të nevojshme.
4. Kontrolluesi, detyrimet rekomanduese të dala nga ky akt i Komisionerit, duhet ti realizojë brenda një afati kohor, prej 30 ditësh.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 09.3.2016

